



KOSOVO CSR
NETWORK

PLANI STRATEGJIK PËR
PËRGJEGJËSINË SHOQËRORE
KORPORATIVE NË KOSOVË

2021
-
2025



TABELA E PËRMBAJTJES

- Përmbledhje Ekzekutive ⁰³
- Parathënie ⁰⁵
- Hyrje ⁰⁶
- Rruga drejtë Hartimit të Planit Strategjik për CSR (2021-2025) ⁰⁷
- Vizioni dhe Misioni ⁰⁷
- Objektivat Kryesore ⁰⁹
- Veprimet Konkrete ¹⁴
- Palët e Interesit dhe Akterët Relevant ¹⁸



PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Rrjeti CSR Kosova ka zhvilluar një Plan Strategjik të Përgjegjësisë Shoqërore të Ndërmarrjeve (CSR) për Kosovë, e cila është hartuar në përputhje me parimet e organizatës rreth integritetit, paanshmërisë, pavarësisë dhe përgjegjësisë organizative – dhe si i tillë, mund të shërbejë si bazë për Strategjinë Kombëtare të CSR në vend. Ky dokument synon të promovojë krijimin e një strategjie lidhur me përgjegjësinë shoqërore të ndërmarrjeve, si një komponentë thelbësore në kuadër të parimeve të një kompanie, dhe ndër të tjera, ka për qëllim të plotësojë diskutimin lidhur me menaxhimin strategjik të këtij koncepti relativisht të ri në vendin tonë. Kjo nënkupton aftësinë e shteteve përkatëse për krijimin e politikave dhe instalimin e procedurave relevante të cilat përfshijnë në vete brengat kolektive, çështjet mjedisore dhe etike, të drejtat e njeriut, si dhe, ndër të tjerash, kujdesi dhe sjellja ndaj konsumatorit - të gjitha në bashkëpunim të ngushtë me palët e interesit dhe akterët relevant.

Koncepti i Përgjegjësisë Shoqërore Korporative përfshinë të gjitha praktikatat biznesore dhe mënyrat e adresimit ndaj sfidave brenda operacioneve të tyre thelbësore, qoftë në lidhje me të drejtat e njeriut, çështjet mjedisore, përpjekjet anti-korruptive, kodin e etikës dhe sjelljes profesionale, dhe ndër parimet tjera, vullnetarizmin. Me instalimin e praktikave të përgjegjshme për shoqërinë, organizatat marrin përgjegjësi për ndikimin e aktiviteteve të tyre tek klientët, punonjësit, palët e interesit, komunitetet dhe mjedisin. Kjo qasje shtrihet përtej respektimit të ligjeve përkatëse në fuqi, marrë parasysh që organizatat vullnetarisht ndërmarrin hapa për të





PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

përmirësuar cilësinë e jetës për punonjësit dhe rrethin e tyre, si dhe shoqërinë në përgjithësi. Pasi që kjo praktikë ndikon pozitivisht në fisnikërimin dhe mbështetjen e mirëqenies sociale, koncepti i CSR njihet edhe si “korporatë sociale”.

Përgjegjësia shoqërore brenda korporatave dhe organizatave është gjithnjë e më e rëndësishme sot, dhe si e tillë mund të reflektohet në forma të ndryshme -përfshirë kontributin vullnetar për kauza sociale, filantropi, kontributet financiare, mbrojtjen e ambientit dhe iniciativat ekologjike, si dhe shumë praktika relevante me të cilat bizneset, të vogla apo të mëdha, mund të kontribuojnë për të mirën kolektive.

Në përgjithësi, marrë parasysh që arsimimi, si një ndër shtyllat kryesore të zhvillimit të qëndrueshëm (ekonomia, mjedisi dhe shoqëria), dhe poashtu, duke konsideruar që një numër i madh i ekspertëve konsiderojnë që arsimimi konsiderohet një nga instrumentet kryesore për rritjen e qëndrueshmërisë ekonomike, Rrjeti CSR Kosova investon në fuqizimin e të rinjve që nga fillimi i vitit 2019. Për pesë vitet e ardhshme, fuqizimi i të rinjve dhe mbrojtja e mirëqenies së tyre, si dhe krijimi i mundësive për të adresuar dhe mbështetur nevojat e paplotësuara të të rinjve në fushat e arsimit, zhvillimit të aftësive dhe mundësive të punësimit -mbeten disa nga fushat kyçe të fokusit të Rrjetit CSR Kosova, duke synuar arsim dhe edukim cilësor e gjithëpërfshirës për të rinjtë anëmbanë Kosovës.

Pra, Rrjeti ynë synon të kontribuojë në fuqizimin e të rinjve kosovarë, duke rritur kapacitetin dhe

aftësitë e tyre për një qasje të suksesshme në tregun e punës, kapacitete të ngritura për politikë-bërje dhe vendimmarrje -përmes ekspertizës së mentorëve profesional të sektorit privat, ndër të tjerësh. Po ashtu, përveç fuqizimit të të rinjve, Rrjeti CSR Kosova do të fokusohet në avancimin e mëtejshëm të përgjegjësisë shoqërore mjedisore, marrë parasysh rritjen e vazhdueshme të çështjeve mjedisore në nivel ndërkombëtarë, siç janë ngrohja globale dhe reduktimi i mbeturinave dhe deponimi i tyre. Gjithashtu, në partneritet të ngushtë me anëtarët dhe partnerët e jashtëm, përgjatë periudhës së caktuar, kjo organizatë do të angazhohet për rritjen e vazhdueshme të vizibilitetit të CSR, duke kontribouar njëkohësisht në përmirësimin e sjelljes organizative, efektivitetit dhe performancës së organizatës, duke përfshirë avancimin e marrëdhënieve në mes të punonjësve.

Me rëndësi të vecantë, Rrjeti CSR Kosova, do të fokusohet vazhdimisht në fuqizimin e grave dhe vajzave, specifikisht në përkrahjen e iniciativave legjislativë për përfaqësimin e denjë dhe gjithëpërfshirës të grave në pozita udhëheqëse dhe aftësimin profesional të vajzave, respektivisht, duke u bazuar në praktikat e shteteve relevante brenda Bashkimit Evropian. Implementimi i kësaj Strategjie kërkon përfshirje më të gjerë që tejkalon kapacitetin e një organizate të vetme, prandaj, zbatimi i Planit Strategjik të Rrjetit CSR Kosova kërkon koordinim dhe bashkëpunim ndërmjet palëve të interesit nga sektori privat, agjencitë qeveritare, organizatat ndërkombëtare, shoqëria civile, dhe ndër të tjerë, komuniteti i donatorëve.



PARATHËNIE



LINDA TAHIRI
DREJTORE EKZEKUTIVE
RRJETI CSR KOSOVA

Me shumë kënaqësi dhe nder, po ju drejtohem, unë Linda Tahiri, në cilësinë e Drejtores Ekzekutive, për të ripotencuar rëndësinë që ka përgjegjësia shoqërore korporative (CSR) për sektorin privat, dhe ndikimin e saj madhor në mbarë shoqërinë. Integrimi i elementeve shoqërore, mjedisore e etike në praktikën e të bërit biznes, mbetet një instrument kyç për përcaktimin e kahjes globale drejtë një bote të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse. Përgjegjësia Shoqërore Korporative (CSR) synon të rrisë qëndrueshmërinë e shoqërisë sonë, duke përfshirë përmirësimin e shëndetit, mirëqenies dhe prosperitetit, dhe ne, si Rrjet besojmë që implementimi i një Plani të tillë për integrimin e CSR, kontribuon në ndërtimin e një shteti me kohezionin social e objektiva të lidhura me një sistem modern

arsimor, dhe një sistem adekuat të kujdesit cilësor shëndetësor.

Rrjeti CSR Kosova veçse ka krijuar një momentum të jashtëzakonshëm në sferën e biznesit, duke synuar kështu rritjen e rëndësisë së CSR-it në adresimin e sfidave të aspektit shumë dimensional, përfshirë të drejtat e njeriut; të drejtat e punëtorëve; çështjet mjedisore; luftimin e korrupsionit; dhe çështjet e ndryshme të karakterit social.

Kjo Strategji ka për qëllim të krijojë një kornizë partneriteti, e cila do të lehtësohnte dhe forconte bashkëpunimin në mes të institucioneve shtetërore, sektorit privat, dhe ndër të tjerësh, donatorëve ndërkombëtarë, në instalimin e praktikave të përgjegjshme biznesore dhe motivimin tonë për të vepuar në sferat shoqërore, duke investuar dhe kontribuar së bashku në krijimin e një shoqërie të përgjegjshme ekologjike dhe të barabartë. Pra, për të siguruar zbatimin efektiv të këtij Plani Strategjik, kërkohet angazhim dhe partneritet ndërsektorial, koordinim dhe bashkëpunim kreativ si me sektorin privat, sektorin qeveritar e jo-qeveritar, dhe komunitetin e donatorëve lokal dhe ndërkombëtar. Rrjeti CSR Kosova do të vazhdojë të përkushtohet maksimalisht në arritjen e një zhvillimi të qëndrueshëm, duke promovuar konceptin, idetë dhe veprimet konkrete që rrisin ndikimin e Përgjegjësisë Sociale të Korporatave (CSR) në shoqërinë e Kosovës, duke riorientuar kështu zhvillimin ekonomik dhe social drejtë një Kosove të qëndrueshme dhe funksionale.

HYRJJE

Zhvillimi i Planit Strategjik për Përgjegjësi Shoqërore Korporative në Kosovë, proces ky që do të udhëhiqet nga Rrjeti CSR Kosova, ka si qëllim primar promovimin e konceptit, ideve dhe veprimeve konkrete që mundësojnë rritjen e ndikimit të CSR në shoqërinë kosovare dhe adresimin e sfidave relevante që ka kjo shoqëri.

Në kuadër të këtij Plani, objektivat aktuale do të shtjellohen dhe zbatohen në bashkëpunim me

anëtarët e Rrjetit CSR Kosova, sektorin privat në përgjithësi, institucionet vendore dhe ndërkombëtare, si dhe njësi të ndryshme të shoqërisë civile. Këto objektiva do të përmbushen në tërësi, vetëm nëse ekziston një koordinim dhe proaktivitet nga të gjithë aktet e lartëcekur, duke promovuar vlerat e praktikave të CSR, si një domosdoshmëri për një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik.

Rruga drejtë Hartimit të Planit Strategjik për CSR, 2021-2025

Draftimi i Planit Strategjik – Plani i Punës – (2021-2025)

AKTIVITETE	PERIUDHA	PALËT E INTERESIT
Propozimi i Konceptit në Bord	Qershor 2020	Rrjeti CSR Kosova (Ekzekutivi)
Hartimi i Draftit të Parë	Fundi i shtatorit (30 shtator)	Rrjeti CSR Kosova
Retreat me Anëtarët e Bordit	Tetor 2020	Zyra e Rrjetit CSR Kosova & Anëtarët e Bordit
Drafti Aktual ndahet me Anëtarët e Rrjetit	12-29 nëntor, 2020	Anëtarët e Rrjetit CSR Kosova
Rifreskimi dhe plotësimi i draftit	20 nëntor, 2020	Rrjeti CSR Kosova
Konsultimet me aktet e relevant për draftin aktual	23 nëntor – 11 dhjetor 2020	Sektori privat, agjencitë qeveritare, shoqëria civile, organizatat donatore.
Rifreskimi dhe plotësimi i draftit aktual	Deri më 16 dhjetor, 2020	Rrjeti CSR Kosova
Aprovimi i Draftit Final në Kuvend	Shkurt, 2021	Anëtarët e Kuvendit të Rrjetit CSR Kosova



VIZIONI DHE MISIONI

Një strategji e bazuar në Qëllimet e Zhvillimit të Qëndrueshëm, OZhQ-ve

Që nga themelimi, Rrjeti CSR Kosova ka qenë dhe vazhdon të jetë zotëruesi i bashkëpunimit praktik për kompanitë përgjegjëse ndaj shoqërisë. Kjo organizatë synon fuqishëm të vazhdojë shërbimin si platformë ku bizneset mund të luajnë rolin e tyre kyç -si kontribues thelbësor në ndryshimet shoqërore dhe ekonominë gjithëpërfshirëse. Rrjeti CSR Kosova ka për qëllim të përgjithshëm të demonstrojë se Përgjegjësia Shoqërore Korporative, është një proces i natyrshëm, i cili duhet të instalohet, për periudha afatgjate, në politikat e çdo organizate apo institucioni. Për pesë vitet e ardhshme, aktivitetet dhe përpjekjet e organizatës do të fokusohen tek Objektivat te caktuara të Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZhQ-të), të cilat përshtaten me politikat e brendshme dhe operacionet biznesore, modelet dhe vizionin e anëtarëve dhe bashkëpunorëve tanë.

Roli i Bizneseve

Sipas Rrjetit CSR Kosova, bizneset dhe ndërmarrjet anëtare, duke përfshirë partnerët tanë bashkëpunorë, janë të vendosur në mënyrë të fuqishme, për t'i shërbyer mirëqenies publike dhe të mirës së shoqërisë, duke i përcjellur trendet globale dhe duke u qendruar afër qytetarëve përmes veprimtarive të tyre të përgjegjësisë sociale. Rrjeti CSR Kosova vlerëson se anëtarët tanë, dhe sektori privat në përgjithësi, janë në gjendje të zbusin shqetësimet sociale duke ridrejtuar përparësitë e tyre, dhe duke transformuar modelet e tyre të biznesit për një qasje më të qëndrueshme të zhvillimit. Ne synojmë të shohim partnerët tanë të

zbatojnë mënyra për të përtërirë proceset e tyre për të siguruar një vend pune etik dhe gjithëpërfshirës, të krijojnë partneritete brenda industrive përkatëse, të angazhohen për reduktimin e mbeturinave dhe të inkurajojnë deponimin e rregullt të tyre, të avokojnë për implemetimin e projekteve ekologjike dhe iniciativa mjedisore, dhe ndër të tjera, të kontribuojnë në rritjen e zhvillimit ekonomik, duke nxitur njëkohësisht angazhimin e përkushtuar dhe konsistent të zvogëlimit të gjurmëve të emetimeve të karbonit, sipas zbatueshmërisë.



Partneritet dhe prosperitet

Rritja e bashkëpunimit në mes të anëtarëve dhe partnerëve potencial, organizatave qeveritare dhe joqeveritare, partnerë ndërkombëtarë, agjencie të fokusuara në zhvillimin e qëndrueshëm dhe përmbushjen e Agjendës 2030, të inicuar nga Kombet e Bashkuara, janë disa nga objektivat kyçe të Planit Strategjik të Rrjetit CSR Kosova, për pesë vitet e ardhshme.

OBJEKTIVAT KRYESORE

Në përfrim me vizionin e punës së organizatës CSR Europe, për të ardhmen e afërt, Rrjeti CSR Kosova është pozicionuar në vend kyç, për të ofruar agjendë të qëndrueshmërisë dhe inovacionit social përmes partneriteteve, dhe në mënyrë të pashmangshme të përmbushë Qëllimin 17 të Zhvillimit të Qëndrueshëm - Partneritetet për Qëllimet.

Rrjeti CSR Kosova ka selektuar tetë fusha tematike të Qëllimeve të Zhvillimit të Qëndrueshëm, OZhQ-ve, si një kornizë për ndërthurjen e përpjekjeve tona rreth praktikave të CSR, me vendosmërinë për të kontribuar në përmbushjen dhe arritjen e OZhQ-ve. Kjo fushatë do të drejtojë gjithashtu agjendat e anëtarëve tanë, sa i përket angazhimit dhe kontributit për shoqërinë, dhe do të sigurojë pozicionin e tyre si anëtarë të përgjegjshëm të

shoqërisë dhe biznese të qëndrueshme, të cilat punojnë vazhdimisht në përhapjen e ndikimit të tyre shoqëror dhe mjedisor, duke kontribuar në krijimin e një klime më të favorshme për një zhvillim më të qëndrueshëm në vend.

Kontributi i sektorit privat në partneritet me akterët relevant, sipas Rrjetit, ndihmon fuqishëm arritjen e zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik dhe shoqëror, duke inkurajuar vazhdimisht nisma zhvillimore dhe zgjidhje të qëndrueshme në Kosovë.

Tabela më poshtë (Tabela 1) do të shërbejë si një mekanizëm bashkëpunimi për angazhimin e palëve të interesuara për përmbushjen e OZhQ-ve, duke përfshirë sektorin privat ndër të tjerësh, për zhvillim ekonomik, social dhe mjedisor.



Tabela 1: Udhërrëfyes për Përbushjen e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm, OZhQ-ve)

QËLLIMI	INTERVENIMI I PARTNERËVE	FUSHAT E INTERVENIMIT NGA SEKTORI PRIVAT DHE ANËTARËT E RRJETIT CSR KOSOVA
	- Ministria e Shëndetësisë; - Instituti Kombëtar për Shëndetësi Publike, IKSHP; - Organizata Botërore e Shëndetësisë, OBSH; - UNHCR; - Qendrat e Mjekësisë Familjare (Niveli Lokal); - Grupet Private të Mirëqenies; - Programi i UNICEF-it në Kosovë; - Action for Mothers and Children (AMC).	- Sigurimi i qasjes në shërbime të kujdesit shëndetësor dhe vaksinave, përmes aktiviteteve të përgjegjshme ndaj shoqërisë; - Mbështetje për kujdesin shëndetësor gjithëpërfshirës për komunitetet pakicë dhe në zona rurale; - Adresimi dhe menaxhimi i faktorëve mjedisorë që kontribuojnë në një nivel të dobët të shëndetit fizik/mendor; - Kujdesi për nëna dhe fëmijë në fazën e hershme – përfshirë periudhën para lindjes – informatë relevante për shëndetin dhe rëndësinë e vaksinimit (gjuhë shqipe dhe serbe).
	- Programi i UNICEF-it në Kosovë; - Agjencia Austriake për Zhvillim, ADA; - USAID Kosovë; - Kosova Education Center, KEC; - TOKA; - Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale; - Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit; - Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë.	- Programet e aftësimi profesional dhe edukimit jo-formal; - Mbështetja për qasje në skemat e punës praktike; - Krijimi dhe avancimi i programeve për punë praktike në fusha inovative dhe/apo deficitare; - Promovimi dhe/apo organizimi i aktiviteteve ndërgjegjësuere për krijimin dhe/apo përmirësimin e mundësive të barabarta për avancim profesional; - Inkurajimi i vullnetarizmit, si praktikë e përgjegjshme ndaj shoqërisë.
	- UN Women; - Programi i UNICEF-it në Kosovë; - USAID Kosovë; - Agjencia për Barazi Gjinore (Zyra e Kryeministrit); - Fondacioni Kosovar i Mijëvjeçarit, MFK, Departamenti Gjinor; - Këshilli i Evropës.	- Vendosja e parimeve të barazisë gjinore në politikat dhe proceset e brendshme të ndërmarrjeve/kompanive; - Promovimi i sigurimit të mundësive për pagë të barabartë, pa marrë parasysh gjininë, religjionin, dhe etnicitetin, ndër të tjerash; - Promovimi dhe lobimi i pjesëmarrjes së grave në zhvillimin e politikave dhe hartimin e buxhetit, krahas proceseve tjera vendimmarrëse; - Lobimi për pjesëmarrje të lartë të grave në borde, krahas pozitave të tjera vendimmarrëse;

Tabela 1: Udërrëfyes për Përbushjen e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm, OZhQ-ve

QËLLIMI	INTERVENIMI I PARTNERËVE	FUSHAT E INTERVENIMIT NGA SEKTORI PRIVAT DHE ANËTARËT E RRJETIT CSR KOSOVA
	• Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale; • Ministria e Zhvillimit Ekonomik; • UNDP; • UN Women; • USAID Kosovë; • Agjencia Austriake për Zhvillim, ADA; • Programi i UNICEF-it në Kosovë; • Kosova Education Center, KEC.	• Sigurimi i mundësive për punë produktive, duke përfshirë sigurimin e të ardhurave të ndershme; • Aftësimi profesional i të rinjve, duke rezultuar me përshtatjen e aftësive të tyre me kërkesat e tregut të punës; • Promovimi dhe ndërtimi i ekonomisë së përqëndruar në mirëqenien e përgjithshme të shoqërisë.
	• Ministria e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë; • Ministria e Zhvillimit Ekonomik; • GIZ Kosova; • Fondacioni Kosovar i Mijëvjeçarit, MFK; • Sustainability Leadership Kosova, SLK; • Instituti për Politika Zhvillimore, INDEP.	• Promovimi i industrializimit gjithëpërfshirës dhe të qëndrueshëm; • Miratimi i rregulloreve që sigurojnë që iniciativat e ndërmarrjeve menaxhohen në mënyrë të qëndrueshme;
	• Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit; • GIZ Kosova; • Agjencia Japoneze për Bashkpunim Ndërkombëtar, JICA; • Sustainability Leadership Kosova, SLK; • Instituti për Politika Zhvillimore, INDEP; • KEDS Kosova.	• Promovimi i zgjidhjeve të reja që mundësojnë konsum dhe prodhim të qëndrueshëm; • Mbështetje për identifikimin e “pikave të nxehta” brenda zinxhirit të vlerës dhe ndërmarrja e masave zbutëse; • Mbështetja për zvogëlimin e mbeturinave; • Promovimi i ekonomisë qarkore – dhe ndryshimi i tarifave ose taksave për transformimin e kompanive në ekonominë qarkore; • Angazhimi në matjen dhe raportimin e treguesve për OzhQ-të relevante për çështjet mjedisore, specifike për kontekstin e Kosovës.

Tabela 1: Udhërrëfyes për Përmbushjen e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm, OZhQ-ve

QËLLIMI	INTERVENIMI I PARTNERËVE	FUSHAT E INTERVENIMIT NGA SEKTORI PRIVAT DHE ANËTARËT E RRJETIT CSR KOSOVA
	• Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit; • KEDS Kosova; • Agjencia për Mbrojtje të Mjedisit • Programi i Zhvillimit të Qëndrueshëm të Kombeve të Bashkuara, UNDP • Sustainability Leadership Kosova, SLK; • Instituti për Politika Zhvillimore, INDEP; • KEDS Kosova.	• Promovimi i menaxhimit të qëndrueshëm të mjedisit, riciklimit dhe efikasitetit të energjisë; • Promovimi për restaurimin e pyjeve të degraduara; • Lobimi për ndalimin e shpyllëzimit dhe degradimit të tokës; • Transformimi i prokurimit publik në atë të gjelbër (PMP);
	• Institucionet Qeveritare; • Kuvendi i Kosovës; • Organizatat; ndërkombëtare/donatorë potencial; • Shoqëria civile; • Institucionet akademike; • Sektori privat.	• Mobilizimi për zhvillimin e teknologjisë dhe ndërtimin e kapaciteteve; • Promovimi dhe lobimi për ndryshimin e Ligjit përkatës për Prokurim Publik,¹ duke avokuar për ligje miqësore me prokurimin e gjelbër; • Mobilizimi i partneriteteve ndërsektorale për të rritur progresin shoqëror dhe ekonomik përmes zbatimit të ligjeve dhe politikave të tjera përkatëse.

1

LIGJI NR. 05/L-068 PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR. 04/L-042 PËR PROKURIMIN PUBLIK TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, I NDRYSHUAR DHE PLOTËSUAR ME LIGJIN NR. 04/L-237
<https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=11332>

NGRITJA E VIZIBILITETIT TË RRJETIT CSR KOSOVA

Për të siguruar një ndikim pozitiv në zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik dhe shoqëror, Rrjeti CSR Kosova do të përqendrojë burimet e veta për të rritur dukshmërinë e aktiviteteve të Përgjegjësishë Shoqërore Korporative, që promovojnë ndikim pozitiv në reputacionin e kompanive, vetëdijen e konsumatorit dhe performancën në vend të punës, ndër të tjera.

Rrjeti CSR Kosova tashmë ka krijuar partneritete me organizata apo institucione të tjera që mbështesin vizionin e organizatës. Këto partneritete do të kultivohen më tej për të zgjeruar shtrirjen e Rrjetit, dhe gjithashtu dukshmërinë e iniciativave të partnerëve tanë, për të rritur vlerat dhe për të promovuar qëndrueshmërinë sociale dhe zhvillimin e qëndrueshëm të mjedisit.

Në përputhje me përmbushjen e OZhQ-ve të synuara, aktivitetet e planifikuara do të kërkojnë pjesëmarrjen, partneritetin e shumëfishtë, dhe kontributin e të gjithë anëtarëve dhe akterëve relevant. Duke iu qasur dhe duke shënjestruar secilin qëllim (OZhQ) të caktuar, me një veprim specifik, jo vetëm që promovohen parimet tona kyçe, por gjithashtu kontribuohet në rritjen e vizibilitetit të anëtarëve tanë dhe të organizatës në tërësi. (Për më shumë rreth kësaj, informatat përkatëse elaborohen tek matrica e aktiviteteve, fq. 10&11).

Objektivat specifike për Rrjetin CSR Kosova përfshijnë:

- Rritja e ndërgjegjësimit në mesin e audiencave kryesore (brenda dhe jashtë Rrjetit) për punën, vizionin dhe aktivitetet e Rrjetit CSR Kosova;
- Përforcimi dhe zhvillimi i mëtutjeshëm i rolit të Rrjetit CSR Kosova -si përcaktues aktiv i standardeve kyçe në fushën e përgjegjësishë shoqërore të korporatave;
- Vazhdimi i mbështetjes për nismat e anëtarëve, në vlerësimin e natyrës gjithëpërfshirëse të zhvillimit të qëndrueshëm, mbrojtjen e mjedisit dhe iniciativat të tjera që sigurojnë një mjedis dhe projekte ekologjike;
- Rritja e Ndërgjegjësimit për rolin e Rrjetit CSR Kosova, si gjenerues i njohurive për CSR, tek audiencat e synuara;
- Maksimizimi i potencialit të partneriteteve me akterë të tjerë (Qeveria e Kosovës, organizatat ndërkombëtare që veprojnë në Kosovë, anëtarë të Rrjetit CSR Kosova) si pjesë e qasjes kolektive drejt avancimit të profilit të Rrjetit CSR Kosova.

NGRITJA E VIZIBILITETIT TË RRJETIT CSR KOSOVA

Mesazhet kyçe

- Rrjeti CSR Kosova është një organizatë unike që ofron rezultate mbi angazhimet thelbësore dhe iniciativat përkatëse për shtrirjen e praktikave të Përgjegjësisë Shoqërore Korporative;
- Rrjeti CSR Kosova aktualisht mbetet e vetmja organizatë në vend, veprimtaria e së cilës i kushtohet zhvillimit të qëndrueshëm, mbrojtjes së mjedisit dhe ndër të tjerash, funksionimit etik të sektorit privat;
- Roli i Rrjetit CSR Kosova, si një promovues kombëtar i standardeve në promovimin e përgjegjësisë shoqërore korporative, dhe mekanizëm integruar për perspektivën gjinore në politika publike, zhvillimin e mëtutjeshëm dhe ngritjen e kapaciteteve, promovimin e instalimit të edukimit cilësor.

Mjetet dhe mundësitë e komunikimit

- Punëtori me tematika të ndryshme, vazhdimisht duke u fokusuar në arritjen e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm, në përputhje me praktikën e përgjegjësisë shoqërore korporative;
- Seminare trajnimi;
- Tryeza të rrumbullakëta dhe diskutime publike;
- Përfshirja e Rrjetit CSR Kosova në grupe punuese për ligje reformuese relevante për praktikën e CSR;
- Udhëtime/vizita studimore;
- Debate tematike që rrisin dukshmërinë mbi praktikën e CSR, arsimin jo-formal dhe fuqizimin e të rinjve, instalimin e skemave të punës praktike, fuqizimin e grave, mbrojtjen e mjedisit dhe

projekteve ekologjike, mbrojtjen të drejtave të punëtorëve, ndër të tjera.
Imazhi

- Imazhi i Rrjetit CSR Kosova është zhvilluar në bazë të parimeve themelore të transparencës, përgjegjësisë dhe llogaridhënies, duke promovuar konceptin dhe filozofinë e praktikave korporative të përgjegjshme ndaj shoqërisë, dhe njëkohësisht duke kontribuar në ridimensionimin e jetesës për një zhvillim të qëndrueshëm.
- Rrjeti CSR Kosova ngërthen në vete një vizion madhor për zhvillim të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës, duke kontribuar në përmirësimin e cilësisë së jetesës së personelit dhe anëtarëve, dhe shoqërisë në tërësi. Kjo organizatë fokuson përpjekjet e saj në inkurajimin e sektorit privat në ndjekjen e qëllimeve afatgjata të dobishme shoqërore, duke promovuar integrimin e parametrave ekonomik, social dhe mjedisor në operacionet biznesore.



VEPRIME KONKRETE

Shpërndarja e Praktikave të Përgjegjësishë Shoqërore Korporative

Rrjeti CSR Kosova është vazhdimisht i fokusuar në punën e tij drejtë implementimit të suksesshëm të misionit brenda komunitetit të biznesit, duke u angazhuar në përhapjen gjithënjë e më të gjerë të filozofisë së Përgjegjësishë Shoqërore Korporative, efektin e kësaj praktike në shoqëri, ekonomi dhe mjedis, përmes së cilës, kompanitë dhe entitetet përkatëse në mënyrë vullnetare kontribuojnë për të mirën e shoqërisë, përtej detyrimeve ligjore.

Rrjeti do të ndërmarrë veprime që promovojnë vizionin dhe filozofinë e organizatës, duke reflektuar vlerat e partnerëve tanë tek akterët dhe bashkëpunëtorët e tjerë të shoqërisë. Rrjeti CSR Kosova do të llobojë tek bashkëpunëtorët dhe partnerët për t'u bashkuar zyrtarisht në Rrjet, dhe të angazhohen për zbatimin e parimeve të përgjegjësishë shoqërore brenda kapaciteteve të tyre, dhe të kontribuojnë në përmbushjen e OZhQ-ve të synuara.

Në të njëjtën kohë, Rrjeti do të mbështesë anëtarët për të investuar në komunitetet ku ata veprojnë përmes iniciativave në përputhje me përgjegjësinë shoqërore korporative (përshtembull, aktivitete që promovojnë tutje përmbushjen e kriterëve për arritje të barazisë gjinore, trajnime profesionale, zhvillimin e mëturtyeshëm të punonjësve dhe respektimin e të drejtave të tyre themelore, mbrojtjen e mjedisit dhe inkurajimin e projekteve ekologjike, promovimin e vlerave anti-korruptive, ndër të tjerash).

Ngritja e Kapacitetit të Brendshëm në Rrjetin CSR Kosova

Në mënyrë që Rrjeti CSR Kosova të vazhdojë me përpjekjet e tij drejtë rritjes së kuptimit të rolit të CSR në një shoqëri demokratike në opinionin e gjerë, sektorin privat dhe tek autoritetet publike, të lehtësojnë koordinimin me rrjetet brendat sektorit të shoqërisë civile, si dhe të strukturojnë bashkëpunimin në mes sektorit privat, shoqërisë civile dhe autoriteteve publike -do të fokusohet në ngritjen e vazhdueshme të kapaciteteve të brendshme.

Organizata do të investojë në, ndër të tjerash, përmirësimin e parimeve themelore të qeverisjes së mirë të brendshme, përmirësimin e njohurive rreth organeve dhe strukturave vendim-marrëse dhe menaxhuese dhe funksionimi i tyre, sistemet dhe strategjitë e transparencës dhe llogaridhënie, roli i shoqërisë civile në hartim dhe zbatim të politikave publike, trajnimi i stafit punues të Rrjetit CSR Kosova rreth kornizës ligjore kombëtare në lidhje me politikën e CSR, kapacitetet për ngritjen e fondeve për OShC-të, format dhe mënyrat e përkrahjes së organizatave të shoqërisë civile, koordinimi i profilit të donatorëve me nevojat dhe veprimtarinë e Rrjetit.

Po ashtu, kjo organizatë do të avokojë për përfshirjen dhe angazhimin e saj në grupet përkatëse punuese rreth draftimit të ligjeve në lidhje me përgjegjësinë shoqërore korporative, duke përfshirë këtu edhe përpjekjet e vazhdueshme në partneritet të shumëfishtë, në ekspozimin e pikave të dobëta të identifikuara në legjislacionet ekzistuese dhe projektligjet.



VEPRIME KONKRETE

Çështjet Mjedisore dhe Mbrojtja e Ambientit

Rrjeti CSR Kosova, përgjatë periudhës pesë vjeçare, do të trajtojë ndikimin në mjedis përmes një qasjeje dy-nivelesh. Së pari, organizata do të mbështesë dhe inkurajojë anëtarët të instalojë politikat e ekonomisë qarkore për të zvogëluar efektet e dëmshme në mjedis nga aktivitetet e biznesit të tyre; të tilla si, instalimi i pajisjeve të dizajnuara për energji eficiente, shfytëzimi i hapësirave punuese në përputhje me politikat e gjelbëra, zvogëlimi ose eliminimi i mbeturinave, instalimi i menaxhimit të qëndrueshëm të ujit, dhe në përgjithësi, eliminimi i gjurmëve të karbonit.

Për më tepër, Rrjeti CSR Kosova do të inkurajojë anëtarët për transparencë të plotë, sa i përket ofrimit të informacioneve lidhur me ndikimin e operacioneve të tyre biznesore në mjedis, për të gjitha palët e interesit dhe akterët relevant. Rrjeti CSR Kosova do të qëndrojë i përkushtuar për përmbushjen e OZhQ-ve të fokusuara në mjedis, si në vijim: Qëllimi 12: Prodhimi dhe Reduktimi i Përgjegjshëm dhe Qëllimi 15: Jeta në Tokë.

Rrjeti CSR Kosova do të shfrytëzojë partneritetet ekzistuese, bashkëpunime të tjera me partnerë potencial -për të promovuar menaxhim të qëndrueshëm të mjedisit, dhe ndër të tjerash, për të pranuar këshilla profesionale dhe ekspertizë në përputhje me ligjet përkatëse dhe masat lehtësuese ndaj mjedisit.

Po ashtu, Rrjeti CSR Kosova do të investojë në ngritjen e vetëdijes kolektive për rëndësinë e

ambientit dhe krijimin e ekonomisë qarkore brenda dhe jashtë sektorit privat, duke punuar në edukimin dhe informimin e sektorëve përkatës, më qëllim përfundimtar të sigurimit të një modeli ekonomik të qëndrueshmërisë së jetës njerëzore për një periudhë afatgjatë. Informimi dhe vetëdijësimi i sektorit privat dhe i entiteteve relevante, do të përfshijë, ndër të tjerash, informimin esencial rreth ekonomisë qarkore, duke përfshirë edhe aspektet përkrahëse që mundësojnë ndërtimin e saj. Më përkushtim të veçantë, në koordinim me anëtarët dhe partnerët, Rrjeti CSR Kosova do të fokusohet në promovimin dhe inkurajimin e adresimit të sfidave kryesore zhvillimore në Kosovë, si menaxhimi i mbeturinave dhe ekonomia qarkore, menaxhimi i ujërave, promovimi i energjisë së ripërtëritshme dhe masave të nevojshme për efikasitet të energjisë.

Promovimi i Punës së Denjë dhe Mbrojtja e të Drejtave të Punëtorëve

Për periudhën pesë vjeçare dhe jo vetëm, Rrjeti CSR Kosova do të fokusohet në promovimin e punës së dinjitetshme, respektimin e të drejtave të punëtorëve në vendin e punës, duke rezultuar me arritjen e objektivës përfundimtare – zhvillimin e qëndrueshëm në vend. Rrjeti CSR Kosova vlerëson punonjësit e tij, dhe rrjedhimisht, ndjekë praktikën e burimeve njerëzore që promovojnë mundësi të barabarta në rekrutim, punësim dhe zhvillim, pavarësisht nga gjinia, origjina etnike, dhe fetare, ndër të tjerash. Prioritetet e

VEPRIME KONKRETE

organizatës përfshijnë respektimin e individualitetit dhe përputhjes së plotë me ligjet kombëtare dhe udhëzimet vullnetare ndërkombëtare, siç janë Deklarata Universale e OKB-së për të Drejtat e Njeriut. Po ashtu, Rrjeti CSR Kosova do të avokojë vazhdimisht tek autoritetet vendore për të siguruar koherencë dhe pajtueshmëri me standardet dhe normat ndërkombëtare, siç është legjislacioni i BE-së, Karta Sociale e Evropës, konventat e Kombeve të bashkuara dhe Organizatës Ndërkombëtare të Punës, ILO, duke përfshirë këtu lobimin për adaptimin e mekanizmave ndërkombëtare.

Rrjeti CSR Kosova do të vazhdojë të kontribuojë jo vetëm në sferën biznesore, por njëkohësisht do të avokojë për mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve. Pra, Rrjeti do të insistojë në respektimin e plotë dhe implementimin e paanshëm të dispozitave ligjore lidhur me të drejtat e punëtorëve, duke adresuar njëkohësisht diskriminimin gjinor në punësim dhe avancim profesional e akademik.

Fuqizimi i të rinjve dhe grave

Marrë parasysh misionin shumëvjeçar për fuqizimin e të rinjve dhe grave, si dhe në përgjithësi, punën drejtë avansimit të barazisë gjinore, Rrjeti CSR Kosova ka planifikuar një sërë aktivitete, të cilat synojnë përfshirje më të madhe të vajzave në sektorin e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (ICT), dhe ndër të tjerash, aftësimin dhe zhvillimin e mëtutjeshëm profesional të vajzave në vend, përmes mentorimit dhe këshillimit profesional, në bashkëpunim të ngushtë me anëtarët e Rrjetit,

komunitetin e donatorëve potencial, dhe po ashtu, përfaqësues qeveritarë dhe shoqëri civile. Me implementimin e aktiviteteve dhe iniciativave të sapo-përmendura, Rrjeti CSR Kosova planifikon të kontribuojë fuqishëm në arritjen e Objektivave 4 & 5, në kuadër të Agjendës 2030, të përpiluar nga Kombet e Bashkuara, të cilat fokusohen në ofrimin e edukimit cilësor dhe avancimin e barazisë gjinore.

Po ashtu, si akt emancipues dhe masë afirmative për ta ndryshuar situatën e pabarabartë gjinore në Kosovë, Rrjeti jonë, përgjatë kësaj periudhe pesë vjeçare dhe jo vetëm, do të kontribuojë vazhdimisht në implementimin e sukseshëm të Ligjit për Shoqëri Tregtare, në bazë të cilit, obligohet përfshirja e grave në borde menaxhuese, me kuotë prej 40 %.

Në praktikë, ligji në fjalë, LIGJI NR. 06/L-016 PËR SHOQËRITË TREGTARE,² ani pse siguron rregullim të hendekut në përfaqësimin e grave nëpër borde, sipas hulumtimit përmbajtësor nga Qendra Kosovare për Studime Gjinore,³ gratë vazhdojnë të jenë në numër të vogël në borde siç shihet nga përqindjet e pranura nga ministria përkatëse dhe ndërmarrjet publike. Rrjeti CSR Kosova do të fokusohet në organizimin dhe përkrahjen e fushatave vetëdijësuese dhe legjislative, ndër të tjerash, në mënyrë që ky ligj të ketë efikasitet në praktikë, dhe jo vetëm në letër.

2

LIGJI NR. 06/L-016 PËR SHOQËRITË TREGTARE
<https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=16426>

3

"Kuota Gjinore në Bordet e Korporatave në Kosovë", Qendra Kosovare për Studime Gjinore, Maj 2019.
http://kgscenter.net/site/assets/files/1722/gender_quota_alb.pdf

LISTA E AKTERËVE RELEVANT DHE PALËT E INTERESIT

Akterët relevant që do të jenë të përfshirë në përpilimin e Planit Strategjik të Rrjetit CSR Kosova, dhe kontributi i të cilëve do të jetë me vlerë për organizatën tonë: Zyra e Rrjetit CSR Kosova, anëtarët e Rrjetit CSR Kosova, organet shtetërore

dhe ndërkombëtare, ministritë relevante, shoqëri civile, dhe ndër të tjera, organizata dhe entitete partnere.

Lista e plotë e palëve të interesit dhe bashkëpunëtorëve gjendet më poshtë, si në vijim.

Anëtarët e Rrjetit CSR Kosova

KOMPANIA	EMRI MBIEMRI	POZITA
Raiffeisen Bank	Antigona Limani Bejtullahu	Udhëheqëse e Departamentit të Marketingut dhe Marëdhënieve me Publikun
Titan SharrCem	Vigan Sylejmani	Udhëheqës i Departamentit të Burimeve Njerëzore dhe CSR
ProCredit Bank	Krenare Zajmi-Leti	Udhëheqëse e Njesisë së Marketingut
Meridian Express	Agon Gashi	Drejtor Ekzekutiv
Rugove Corporation	Visar Kelmendi	Drejtor Ekzekutiv
Baker Tilly	Lekë Musa	Partner Menaxhues
Recura Financials	Visar Dobroshi	Partner Menaxhues
Deloitte Kosova	Afrore Rudi	Partnere për Çështje Ligjore
Illyria Insurance	Shpend Balija	Drejtor Ekzekutiv

LISTA E AKTERËVE RELEVANT DHE PALËT E INTERESIT

Anëtarët e Rrjetit CSR Kosova

KOMPANIA	EMRI MBIEMRI	POZITA
KOSTT	Zana Bajrami Rama	Menaxhere e Departamentit të Komunikimit dhe Marëdhënieve me Publikun
PwC	Gresë Rexhepi	Menaxhere në Grupin e Shërbimeve Tatimore
CEED Kosovo	Kreshnik Lleshi	Drejtore
Klubi i Prodhuesve të Kosovës	Astrit Panxha	Drejtore Ekzekutive
American School of Kosova, ASK	Ardian Hoxha	Drejtore Ekzekutive
Flexograf	Berat Mustafa	Drejtore Ekzekutive
Novus Consulting	Pleurat Halili	Drejtore Ekzekutive
Kivo L.L.C	Ariel Shaban	Koordinator Kryesor i Zhvillimit të Biznesit dhe Menaxher i Cilësisë
Plastika	Ardit Shabani	Përfaqësues
REKS	Maliq Gjyshinca	Drejtore Ekzekutive
Art House	Blin Zeqiri	Drejtore Ekzekutive

LISTA E AKTERËVE RELEVANT DHE PALËT E INTERESIT

Institucione Qeveritare/Autoritete Vendore

KOMPANIA

EMRI MBIEMRI

POZITA

Komuna e Prishtinës	Kryetar/e aktuale	Kryetar/e aktuale
Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale	Ministër/e aktuale	Ministër/e aktuale
Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë	Ministër/e aktuale	Ministër/e aktuale
Ministria e Zhvillimit Ekonomik	Ministër/e aktuale	Ministër/e aktuale
Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit	Ministër/e aktuale	Ministër/e aktuale
Ministria e Shëndetësisë	Ministër/e aktuale	Ministër/e aktuale

Donatorë Potencial/Organizata Ndërkombëtare

KOMPANIA

EMRI MBIEMRI

POZITA

CSR Europe	Stefan Crets	Drejtor Ekzekutiv
Programi i UNICEF-it në Kosovë	Murat Sahin	Shef i Zyrës së UNICEF-it, Kosovë
Agjencia Austriake për Zhvillim, ADA	Albulena Zaimi	Menaxhere e Programeve

LISTA E AKTERËVE RELEVANT DHE PALËT E INTERESIT

Donatorë Potencial/Organizata Ndërkombëtare

ENTITETI	EMRI MBIEMRI	POZITA
Programi i Bashkëpunimit për Zhvillim të Qëndrueshem, UNDP	Maria Suokko	Shefe e Zyrës, Kosovë
UN Women	Vlora Tuzi Nushi	Shefe e Zyrës, Kosovë
United Nations Kosovo Team, UNKT	Shpend Qamili	Zyrtar për Kordinim dhe Zhvillim
Këshilli i Evropës	Frank Power	Shef i Zyrës, Kosovë
Oda Ekonomike Gjermano-Kosovare, OEGJK	Nora Hasani	Drejtore Ekzekutive
Shoqata e Bankave të Kosovës, SHBK	Petrit Balija	Drejtor Ekzekutiv
Oda Ekonomike e Britanisë, Kosovë	Bekim Kastrati	Drejtor Ekzekutiv
Advantage Austria Prishtina	Vjosa Huruglica	Shefe e Zyrës, Kosovë
Fondacioni Jahjaga	Alban Bokshi	Drejtor Ekzekutiv
Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile, KCSF	Taulant Hoxha	Drejtor Ekzekutiv
EUROPEAN COMMISSION LIAISON OFFICE	Vadim Deleu	Zyrtar i Politikave

LISTA E AKTERËVE RELEVANT DHE PALËT E INTERESIT

Donatorë Potencial/Organizata Ndërkombëtare

ENTITETI	EMRI MBIEMRI	POZITA
GIZ Kosova	Atdhetare Kelmendi	Këshilltare
Fondi Ndërkombëtar Monetar, IMF	Stephanie Ebel	Përfaqësuese, Kosovë
Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, EBRD	Neil Taylor	Shef i Zyrës, Kosovo
USAID Empower Private Sector	Skender Rama	Drejtator i Programit, Kosovë
HELVETAS Kosovo	Pieter Ypma	Koordinator, Kosovë
Agjencia Suedeze për Zhvillim Ndërkombëtar, SIDA	Nasrin Pourghazian	Përfaqësuese
USAID Kosovë	Matthew Cullinane	Zyrtar për Ndërmarrje Private
Organizata Botërore e Shëndetësisë, OSH	Skënder Syla	Shef i Zyrës, Kosovë
Fondacioni Kosovar i Mijëvjeçarit, MFK	Petrit Selimi	Drejtator Ekzekutiv

LISTA E AKTERËVE RELEVANT DHE PALËT E INTERESIT

Organizata Lokale Jo-Qeveritare

ENTITETI	EMRI MBIEMRI	POZITA
Instituti D4D	Rezarta Delishbashzade-Krasniqi	Drejtoreshë Ekzekutive
Instituti për Politika Zhvillimore, INDEP	Burim Ejupi	Drejtor Ekzekutiv
Këshilli i Konsulentëve për Biznes, BCC	Jehona Lluka	Drejtoreshë Ekzekutive
YMCA në Kosovë	Dorina Lluka Davies	Drejtoreshë Ekzekutive, Kosovë
IPKO Foundation	Abetare Gojani	Drejtoreshë Ekzekutive
Peer Educators Network, PEN	Bujar Fejzullahu	Drejtor Ekzekutiv
Innovation Center Kosova, ICK	Uranik Begu	Drejtor Ekzekutiv
TOKA OJQ	Jehona Gjurgjeala	Drejtoreshë Ekzekutive
Down Syndrome Kosova	Sebahate Beqiri	Drejtoreshë Ekzekutive
Shoqata e Bankave të Kosovës, SHBK	Petrit Balija	Drejtor Ekzekutiv
SOS Fshatrat e Fëmijëve, Kosova	Ora Bytyçi	Drejtoreshë e Programit
Sustainability Leadership Kosova, SLK	Indira Kartallozi	Drejtoreshë Ekzekutive

LISTA E AKTERËVE RELEVANT DHE PALËT E INTERESIT

Shoqëria Civile

ENTITETI	EMRI MBIEMRI	POZITA
"Let's Do it" Kosova	Luan Hasanaj	Drejtore Ekzekutive
Autizmi	Cenë Krasniqi	Drejtore Ekzekutive
Rrjeti i Shitjeve me Pakicë	Korab Hoxha	Kryetar
Rrjeti i Grave të Kosovës, RrGK	Igballe Rogova	Drejtore Ekzekutive
CSR Albania	Klajdi Gjondedaj	Zyrtar për CSR dhe Komunikim

Sektori Privat

ENTITETI	EMRI MBIEMRI	POZITA
Banka Ekonomike	Fatos Krasniqi	Drejtore Menaxhues
IPKO Telecommunications	Robert Erzin	Drejtore Ekzekutive
Teb Bank	Orcun Ozdemir	Drejtore Ekzekutive
Scampa	Kujtim Gjevori	Drejtore Ekzekutive
Trosha	Arben Avdiu	Bashkëthemelues

LISTA E AKTERËVE RELEVANT DHE PALËT E INTERESIT

Sektori Privat

KOMPANIA	EMRI MBIEMRI	POZITA
Toning Group	Faton Hoxha	Pronar
Elkos Group	Fatos Islami	Zv. President
IP Kos	Burim Leci	Drejtore Ekzekutiv
JAHA Solar	Fadil Hoxha	Kryetar Bordi
Albi Mall	Betim Humolli	Drejtore i Zhillimit të Biznesit
Abi L.L.C	Alajdin Fusha	Pronar
VIVA Fresh Store	Xhevdet Rexhepi	Drejtore Ekzekutiv
Euroлона	Milazim Berisha	Pronar
Shell Kosova	Lulzim Kryeziu	Pronar
Trepharm	Mërgim Prishtina	Drejtore Ekzekutiv
Cacttus	Astrit Leti	Partner Menaxhues
Ferronikeli	Edlira Muka	Përgjegjëse
Banka për Biznes	Arton Celina	Drejtore Ekzekutiv
Kujtesa	Vijon Peja	Drejtore

LISTA E AKTERËVE RELEVANT DHE PALËT E INTERESIT

Sektori Privat

KOMPANIA	EMRI MBIEMRI	POZITA
Technomarket	Visar Ramadani	Përfaqësues
Al Trade	Artan Ramaj	Drejtore i Burimeve Njerëzore
Gjirafa	Mergim Cahani	Drejtore Ekzekutiv
Koha Ditore	Flaka Surroi	Drejtoreshë
Gazeta Express	Vjollca Musa	Drejtore e Marketingut
Entermedia	Leutrim Blakaj	Përfaqësues
Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës	Haldun Kokturk	Anëtar Bordi & Kryeshef Ekyekutiv
Asseco	Vigan Budima	Anëtar Bordi
SIGAL	Anila Pishtari	Zv. Drejtore
IQ Consulting	Kushtrim Shaipi	Përfaqësues
Marigona Hill	Valton Bilalli	Drejtore Menaxhues
KEDS Kosova	Alper Erbas	Drejtore Ekzekutiv
SPEEX	Vigan Disha	Drejtore Menaxhues
KRG-Kosova Realty Group L.L.C	Gent Sejdiu	Drejtore Ekzekutiv
Crimson Capital	Michael Gold	Drejtore Menaxhues

LISTA E AKTERËVE RELEVANT DHE PALËT E INTERESIT

Institucione Akademike/Universitete

INSTITUCIONI	EMRI MBIEMRI	POZITA
Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”	Mimoza Ibrani	Prorektore për Mësimdhënie dhe Studentë
Instituti Riinvest	Alban Hashani	Profesor
Kolegji AAB	Lulzim Tafa	Rektor
RIT Kosovo (A.U.K)	Visar Jasiqi	Zyrtar Kryesor për Mobilizim dhe Partneritete
Kolegji Heimerer	Naime Brajshori	Rektore
Kolegji UBT	Edmond Hajrizi	Rektor
Kolegji Riinvest	Alban Zogaj	Dekan për Studime Themelore



Rr. Tringë Smajli Nr.21,
10000 Prishtinë, Kosovë

info@csrkosovo.org